



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.733/20
753/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Security Code” Shpk-Prishtinë, si dhe OE “Delta Security” Prishtinë & “Rosa-Security” shpk Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Alpha Private Security” Shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik për objekte shëndetësore publike (QKMF dhe QMU)” me nr. prokurimi 616-20-1945-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –“KK Prishtinë”, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Security Code” Shpk-Prishtinë dhe OE “Delta Security” Prishtinë & “Rosa-Security” shpk Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik për objekte shëndetësore publike (QKMF dhe QMU)” me nr. prokurimi 616-20-1945-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –“KK Prishtinë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik për objekte shëndetësore publike (QKMF dhe QMU)” me nr. prokurimi 616-20-1945-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –“KK Prishtinë”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Security Code” Shpk-Prishtinë, si dhe OE: “Delta Security” Prishtinë & “Rosa-Security”shpk Prizren, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Security Code” Shpk-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 30.09.2020 me nr. 733/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik për objekte shëndetësore publike (QKMF dhe QMU)” me nr. prokurimi 616-20-1945-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) – “KK Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 28, 59, 60 dhe 31 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE “Delta Security” Prishtinë & “Rosa-Security”shpk Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 02.10.2020 me nr. 753/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik për objekte shëndetësore publike (QKMF dhe QMU)” me nr. prokurimi 616-20-1945-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) – “KK Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7 , 59, 62 dhe 17 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 16.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "SECURITY CODE" SHPK

Përgjigje në pretendimin

Lidhur me pretendimin e OE "Security Code" Shpk, se AK gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Alpha Private Security" Shpk edhe pse analiza financiare e prezantuar nga ky OE nuk mbulon prapësinë e vlerës për pagat e punëtorëve dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit lidhur me detyrimet që dalin nga Ligji i Punës dhe si e tillë kjo ofertë duhet të shpallej e papërgjegjshme, ekspertit shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dorëzojnë një analizë financiare për pagën bazë 250€ bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së, ku ofertuesi se bashku me ofertën duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë 250 € bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku -Pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, pushimet vjetore, -trusti pensional, -fitimi i OE, -TVSH-ja, -Totali i ofertës.

Gjithashtu në dosje të tenderit është specifikuar sqarimi lidhur me kalkulimet e pagave sipas pikave të sigurimit:

- Për pika 24 orësh kemi vetëm 8 orë të ndërrimit të natës.
- Për pika 12 orësh kemi 8 orë të ndërrimit të natës.
- Për pika 8 orësh kemi vetëm orë të ditës.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë "Alpha Private Security" Shpk për pikën 24 orësh dhe për pikën 12 orësh ka kalkuluar çmim të njëjtë të pagës për orë (2.07 € për orë) edhe pse numri i orëve të ndërrimit të natës që paguhen +30% më shumë bazuar në Ligjin e punës për pikën 24 orësh dhe pikën 12 orësh është i ndryshëm dhe është në raport të kundërt.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë "Alpha Private Security" Sh.p.k. tek analiza financiare për pikën 12 orësh ka bërë kalkulim të gabuar tek pozicioni i orëve të ndërrimit të natës, ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është i qëndrueshëm dhe më poshtë po paraqes një analizë të thjeshtë lidhur me këtë pozicion të pikës 12 orësh.

OE i rekomanduar për kontratë në analizën e tij financiare për pikën 12 orësh ka kalkuluar një çmim të shpenzimeve për orë prej 2.07 € që në total për pikën 12 orësh ka kalkuluar vlerën prej **681,403.08 €**

Sipas ekspertit shqyrtues për pikën 12 orësh në tabelën e çmimit të AK-së janë paraparë gjithsej 329,400 orë, që bazuar në sqarimet e AK-së, 8 orë janë të ndërrimit të natës dhe 4 orë të ndërrimit të ditës, që i bie që totali i orëve për ndërrimin e natës është 219,600 orë ndërsa për ndërrimin e ditës totali i orëve është 109,800

orë. Nëse kalkulojmë vetëm çmimin e orëve të ndërrimit të ditës dhe natës pa përfshirë këtu shpenzimet e orëve të festave, pushimeve vjetore apo edhe fitimit të kompanisë vijmë deri te kjo analizë e thjeshtë:

Orët e ditës $109,800 \times 1.42 (250/176) = 155,916.00 \text{ €}$

Orët e natës $219,600 \times 1.84 (1.42 \times 30\%) = 404,064.00 \text{ €}$

Totali i shpenzimeve për orët (329,400) = 559,980.00 €

Kontributi pensional i punëdhënësit 5% = 27,999.00 €

Totali me kontribut pensional = 587,979.00 €

TVSH 18% = 105,836.22 €

Totali me TVSH = 693,815.22 €

Eksperti shqyrtues sqaron se vlera totale e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë (681,403.08 €) nuk e mbulon prapen shpenzimeve për pagat e punëtorëve dhe obligimeve tjera që dalin nga Ligji i punës dhe kërkesat tjera të parashtruar në dosje të tenderit.

AK në vendimin e tij të datës 14.09.2020 ka prezantuar një analizë financiare sipas formulës zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës ku në këtë analizë çmimi për një orë me tvsh është 2.26 €. Konsideroj që AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka vepruar edhe në kundërshtim me analizën e vet financiare duke rekomanduar për kontratë një OE i cili në ofertën e tij ka kalkuluar çmimin prej 2.09 € për orë, që është shumë më e ulët sesa çmimi i prezantuar në analizën e AK-së (2.26 € për orë).

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve konform kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit lidhur me analizën financiare dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Punës, andaj rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe gjatë ri-vlerësimit të respektohen kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me analizën financiare dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Punës. Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “DELTA SECURITY” SHPK

Përgjigje në pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE “Delta Security” Shpk, se AK gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE “Alpha Private Security” Shpk edhe pse kjo ofertë tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës dhe sipas OE ankues edhe ofertat tjera e tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës dhe ky aktivitet i prokurimit konform nenit 62 të LPP-së duhet të anulohet, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit dhe Njoftimin për kontratë vlera e parashikuar e kontratës për këtë aktivitet të prokurimit është përcaktuar në shumë prej 850,000.00 €.

AK përmes sqarimeve shtesë ndaj pyetjes së një OE me datë 06.07.2020 sqaron se:

“Autoriteti Kontraktues ju njofton se aktiviteti i prokurimit është aktivitet me kontratë kornizë prej 36 muajsh. Kjo kontratë mund të realizohet me përqindje + dhe – 30 % të vlerës totale të kontratës. Prandaj OE ofertues duhet të kalkulojnë pagat me analizë financiare sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Kjo kontratë mund të përmbyllet brenda 36 muajsh apo më shumë apo më pak varësisht nga vlera e realizuar për + dhe – 30%”

Eksperti shqyrtues sqaron se për shkak se kemi të bëjmë me kontratë kornizë me afat prej 36 muajsh, është në kompetence dhe përgjegjësi të AK-së, që bazuar në projeksionet/parashikimet buxhetore për tri vitet e ardhshme të vlerësoj se a mund të përfshihet në planifikimet buxhetore shuma e nevojshme për implementimin e kontratës edhe në rastet kur ofertat e tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës. Gjithsesi AK në letrën sqaruese ka specifikuar që kjo kontratë mund të përmbyllet brenda 36 muajsh apo më shumë apo më pak varësisht nga vlera e realizuar për + dhe – 30%” dhe sipas ekspertit shqyrtues pretendimi i OE ankues për anulim të aktivitetit të prokurimit është i paqëndrueshëm.

OE ankues “Delta Security” Shpk është dashur që analizën financiare ta kalkuloj konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe jo të bazohet në vlerën e parashikuar të kontratës.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 17 të Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike për devijim apo keq zbatim të parasë publike ,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse nuk kemi të bëjmë fare me devijim apo keq zbatim të parasë publike. Fondet e planifikuara për këtë aktivitet të prokurimit do të përdoren për sigurim të objekteve të Komunës së Prishtinës dhe nuk ka devijim apo keq zbatim të parasë publike, andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si pjesërisht si të bazuara, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 19.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se kanë pranuar ekspertizën dhe Pajtohen me analizën financiare dhe mendimin e ekspertit shqyrtues

Operatori Ekonomik “SECURITY CODE” SHPK, nuk ka përgjigje

Operatori Ekonomik “Delta Security” Shpk, me datë: 18.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues për kthim te lendes ne **rivlerësim**.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate ka kërkuar raportin e ekspertit dhe ka dhënë përgjigje për atë raport në OSHP si më poshtë:

From: Security Alpha <alphasecur@yahoo.co.uk>

Sent: 23/Nov/20 11:51

To: OSHP <oshp@rks-gov.net>; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>

Subject: Re: Kërkes

Të nderuar

Në atash gjeni një parashtesë ju lutem na e konfirmoni marrjen me respekt

On Friday, 20 November 2020, 10:55:12 CET, Security Alpha <alphasecur@yahoo.co.uk> ërote:

Të nderuar

Pasi që jemi palë me interes kërkojm të na dërgoni ekspertizen për ankesa me nr: 733-753/20.

Me respekt!

Sent from Yahoo Mail for iPhone

Për: ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Nga: "Alpha Private Security" shpk

Lënda: Parashtesë/Sqarim

Të nderuar

Pasi që jemi palë me interes dhe kemi në aktivitetin e prokurimit me nr 616-20-1945-2-1-1 dhe pas ankesave me nr: 733-753/20 të dy OE -ve dhe një ekspertize që është bërë në këto ankesa ne e kundërshtojm mendimin e ekspertit ku ka cekur:

Nëse kalkulimi që ka bërë çmimin e orës është nderimi i të dhënës dhe matës për përshkrim të punës shpenzimeve të orës që kështu e përditësojmë vlerat e punës dhe formën e kompanisë vijonë dhe të kësaj analize e theksojmë:

Orë e dhënë 109,800 x 1.471750 170	152,916,000 €
Orë e matës 222,600 x 1.471750 12 200	328,184,000 €
Totali i shpenzimeve për orë (329,400) =	559,980,000 €
Kontribut pensional i punëdhënësit (5%)	27,999,000 €
Totali me kontribut pensional	587,979,000 €
TVSH 18%	105,836,120 €
Totali me TVSH	693,815,120 €

Eksperti shqyrtues sqaron se vlera totale e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë (684,403,000 €) nuk e mbulon pragun e shpenzimeve për pagu e punëtorëve dhe obligimeve tjera që dalin nga Ligji i punës dhe kërkesat tjera të parashtruara në dosje të tenderit.

Ne nuk e marrim si të sakët këtë kalkulim pasi që forma kalkulimit tonë është bërë sipas Ligjeve dhe rregulloreve në fuqi si dhe kërkesave të AK-së. Por duke parë që eksperti nuk e ka parë (kuptuar) formën e kalkulimit tonë ne po e bashkangjesim të detajuar formën e kalkulimi të ofertës tonë e sidomos tek orari 12 orësh ku eksperti e ka kontestuar.

Ju lutemi referoju tabelës së paraëituar përkatësisht sqarimit nr 2 në tabelë:

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	Totali per nje punetor
1	Paga bruto për orët edites	250.00
2	Oret e nates 30%-Paga 250 pjestuar për 176 orë une(U.AD. (MPMS) Nr. 09/2017)=1.420455 x30%oret e nates =0.426136 *176 orë pune sipas (U.AD. (MPMS) Nr. 09/2017)=75 pjestohet per 4 punetor = 18.75 euro mesatarja per nje punetor. Prova: Paga 250 euro x 30% oret e nates=75 euro pjestohet me 4 punetor=18.75 euro mesatarja per muaj, Arsytimi eshte: 24ore *365dite=8760/12muaj=730 oret mesatare ne muaj, 730ore pjestuarper 176 orëpune(U.AD. (MPMS) Nr. 09/2017)= 4.14 Punetor, qe i ble se gjat nje muaj i jan te angazhuar 4 Punetor per pike 24ore, mesatarja shtes per muaj eshte Paga 250 euro x 30%=75 euro pjestohet me 4 numri i punetorve =18.75 Euro	18.75
3	Oret e festave 50%- Paga 250 pjestuarpër 176 orëpune(U.AD. (MPMS) Nr. 09/2017)=1.420455 x 50%=0.710227 x 288 oret e festave per njevite=204.55 pjestuar per 12muaj=17.04 pjestuar per 3 ndrrime =5.68 Prova: 11 festadhe 12 ditepushim=12*24=288 ore pjestuar per 12 muaj=24 ore pjestuar per 3 ndrrime =8 ore x 0.710227=5.68	5.68
4	Pushimivjetormesatarenëmuaj= 4 jave * 5 ditepune * 8 ore=160*1.420455=227.27/12muaj=18.94	18.94
5	Gjithsejtpagabruto , orëtenatës,festadhepushimivjetor(1+2+3+4)	293.37
6	Trustipensional 5% ipunëdhënësit	14.67
7	Fitimi I Kompanis per nje punetor ne muaj	0.50
8	GjithësjetKostojapërnjepuntor (5+6+7)	308.54
9	Cmimi pa Tvsh per nje ore punepërnjepunëtorpjestuarpër 176 orëpune(U.AD. (MPMS) Nr. 09/2017)	1.75
10	18% TVSH-ja	0.32
11	totali me tvsh per njePuntor	364.08
12	Cmimipër ore pune me tvsh per njëpunëtorpjestuarpër 176 orëpune (U.AD. (MPMS) Nr. 09/2017)	2.07
13	Totali per njemuaj 9150 ore x Cmimi per ore pune	18,927.86
14	Totali per 36 muaj 329400 ore x Cmimi per ore per vendrojet 12 ore	681,403.08

Me respekt:

From: Security Alpha <alphasecur@yahoo.co.uk>

Sent: 25/Nov/20 09:31

To: OSHP <oshp@rks-gov.net>; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>

Subject: Re: Kërkes

Të nderuar

Pasi që jemi palë me interes po i'u dërgojm fakte tjera lidhur me ankesa me nr: 733-753/20.

Me respekt!

On Monday, 23 November 2020, 11:51:26 CET, Security Alpha <alphasecur@yahoo.co.uk> ërote:

Të nderuar

Në atach gjeni një parashtesë ju lutem na e konfirmoni marrjen me respekt

Për të bërë një fakt real lidhur me tabelen e AK të ngarkuar në vendimin e AK-së se si duhet llogaritur paga më poshtë e paraqesim tabelen e AK dhe arsyetimin se pse oferta jonë është në rregull.

#	TABELA E ÇMIMIT PER ORE KU PARASHIHEN TE GJITHA OBLIGIMET SIPAS LIGJIT TE PUNES			
	ORARI I PUNES 08:00 - 16:00			
1		paga minimale bruto		
2	paga minimale EURO	250		
3				
4	kushtet sipas ligjit te punes	ore pune sipas kategorive	Çmimi per nje ore pune sipas kategorise	Çmimet
5	total ore pune sipas ligjit per nje muaj	176 ore mesatare gjate muajit		
6	ore dite - cmimi normal	176	1.42	250.00
7	ore nate - 30%	48	0.43	20.45
8	ore festave - 50%	5.24	0.71	3.72
9	ore vikende - 50%	12.19	0.71	8.65
10	pushim vjetor max. 20 dite sipas ligjit	13.33	1.42	18.94
11	pushim mjeksor max. 20 dite sipas ligjit	13.33	1.42	18.94
12	Kontributi pensional i kompanise (5% punedhenesi)			16.04
13	paga per nje punetor ne muaj			336.74
14	CMIMI TOTAL PER NJE ORE PUNE			1.91
15		TVSH		0.34
	TOTAL CMIMI PER NJE ORE PUNE ME TVSH			2.26

Ne më poshtë po japim vlerat e AK por duke hequr benifitet që as ne dhe asnjë OE nuk i ka kalkuluar në ofertë sepse nuk ka qenë kërkes e AK-së. siq janë (pika 9 dhe 11).

Nr.	Përshtkimi		Qmimet
1	Orët e ditës	1.42	250
2	Orët e natës	0.43	20.45
3	Oërt e festave	50.71	3.75
4	Pushimi vjetor	1.42	18.94
5	Trusti pensional		14.6
6	Total Paga		307.79
7	Total Paga / 176 orë		1.75
8	TVSH		0.31
9	Total çmimi për njësi me TVSH		2.06

Kurse oferta jonë ka vlerën 2.07 për njësi

Ju lusim që të keni parasysh këtë fakët pasi që oferta jonë është me të gjitha kërkesat e AK dhe ligjeve në fuqi duke mos lejuar të përdorën standarte të dyfishta.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE "Security Code" Shpk, se AK gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Alpha Private Security" Shpk edhe pse analiza financiare e prezantuar nga ky OE nuk mbulon prapen e vlerës për pagat e punëtorëve dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit lidhur me detyrimet që dalin nga Ligji i Punës dhe si e tillë kjo ofertë duhej të shpallej e papërgjegjshme.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dorëzojnë një analizë financiare për pagën bazë 250€ bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212 si dhe ATK-së, ku ofertuesi se bashku me ofertën duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë 250 € bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212.OE duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku pagat bazë Bruto 250 € për punëtorë, pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, pushimet vjetore, trusti pensional, fitimi i OE, TVSH-ja, Totali i ofertës.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është specifikuar sqarimi lidhur me kalkulimet e pagave sipas pikave të sigurimit:

- Për pika 24 orësh kemi vetëm 8 orë të ndërrimit të natës.
- Për pika 12 orësh kemi 8 orë të ndërrimit të natës.
- Për pika 8 orësh kemi vetëm orë të ditës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë "Alpha Private Security" Shpk për pikën 24 orësh dhe për pikën 12 orësh ka kalkuluar çmim të njëjtë të pagës për orë (2.07 € për orë) edhe pse numri i orëve të ndërrimit të natës që paguhet +30% më shumë bazuar në Ligjin e punës për pikën 24 orësh dhe pikën 12 orësh është i ndryshëm dhe është në raport të kundërt.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Security Code" Shpk se OE i rekomanduar për kontratë "Alpha Private Security" Sh.p.k. tek analiza financiare për pikën 12 orësh ka bërë kalkulim të gabuar tek pozicioni i orëve të ndërrimit të natës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është i qëndrueshëm dhe më poshtë po paraqes një analizë të thjeshtë lidhur me këtë pozicion të pikës 12 orësh. OE i rekomanduar për kontratë në analizën e tij financiare për pikën 12 orësh ka kalkuluar një çmim të shpenzimeve për orë prej 2.07€ që në total për pikën 12 orësh ka kalkuluar vlerën prej 681,403.08€. Për pikën 12 orësh në tabelën e çmimit të AK-së janë paraparë gjithsej 329,400 orë, që bazuar në sqarimet e AK-së, 8 orë janë të ndërrimit të natës dhe 4 orë të ndërrimit të ditës, që i bie që totali i orëve për ndërrimin e natës është 219,600 orë ndërsa për ndërrimin e ditës totali i orëve është 109,800 orë. Nëse kalkulojmë vetëm çmimin e orëve të ndërrimit të ditës dhe natës pa përfshirë këtu shpenzimet e orëve të festave, pushimeve vjetore apo edhe fitimit të kompanisë vijmë deri te kjo analizë e thjeshtë:

Orët e ditës $109,800 \times 1.42 (250/176) = 155,916.00 \text{ €}$

Orët e natës $219,600 \times 1.84 (1.42 \times 30\%) = 404,064.00 \text{ €}$

Totali i shpenzimeve për orët (329,400) = 559,980.00 €

Kontributi pensional i punëdhënësit 5% = 27,999.00 €

Totali me kontribut pensional = 587,979.00 €

TVSH 18% = 105,836.22 €

Totali me TVSH = 693,815.22 €

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se vlera totale e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë (681,403.08 €) nuk e mbulon prapen e shpenzimeve për pagat e punëtorëve dhe obligimeve tjera që dalin nga Ligji i punës dhe kërkesat tjera të parashtruar në dosje të tenderit. AK në vendimin e datës 14.09.2020 ka prezantuar një analizë financiare sipas formulës zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës, ku në këtë analizë çmimi për një orë me tvsh është 2.26 €. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka vepruar edhe në kundërshtim me analizën e vet financiare duke rekomanduar për kontratë një OE i cili në ofertën e tij ka kalkuluar çmimin prej 2.09 € për orë, që është shumë më e ulët sesa çmimi i prezantuar në analizën e AK-së (2.26 € për orë). Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Delta Security" Shpk, se AK gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE "Alpha Private Security" Shpk edhe

pse kjo ofertë tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës dhe sipas OE ankues edhe ofertat tjera e tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës dhe ky aktivitet i prokurimit konform nenit 62 të LPP-së duhet të anulohet. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë vlera e parashikuar e kontratës për këtë aktivitet të prokurimit është përcaktuar në shumë prej 850,000.00 €. AK përmes sqarimeve shtesë ndaj pyetjes së një OE me datë 06.07.2020 sqaron se:

“Autoriteti Kontraktues ju njofton se aktiviteti i prokurimit është aktivitet me kontratë kornizë prej 36 muajsh. Kjo kontratë mund të realizohet me përqindje + dhe – 30 % të vlerës totale të kontratës. Prandaj OE ofertues duhet të kalkulojnë pagat me analizë financiare sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Kjo kontratë mund të përmbyllet brenda 36 muajsh apo më shumë apo më pak varësisht nga vlera e realizuar për + dhe – 30%”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se për shkak se kemi të bëjmë me kontratë kornizë me afat prej 36 muajsh, është në kompetence dhe përgjegjësi të AK-së, që bazuar në projeksionet/parashikimet buxhetore për tri vitet e ardhshme të vlerësoj se a mund të përfshihet në planifikimet buxhetore shuma e nevojshme për implementimin e kontratës edhe në rastet kur ofertat e tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës. Gjithsesi, AK në letrën sqaruese ka specifikuar që kjo kontratë mund të përmbyllet brenda 36 muajsh apo më shumë apo më pak varësisht nga vlera e realizuar për + dhe – 30%” dhe pretendimi i OE ankues për anulim të aktivitetit të prokurimit është i paqëndrueshëm.

OE ankues “Delta Security” Shpk është dashur që analizën financiare ta kalkuloj konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe jo të bazohet në vlerën e parashikuar të kontratës.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues “Delta Security” Shpk, se AK ka bërë shkelje të nenit 17 të Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike për devijim apo keq zbatim të parasë publike.

Paneli Shqyrtues konform eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse nuk kemi të bëjmë fare me devijim apo keq zbatim të parasë publike. Fondet e planifikuara për këtë aktivitet të prokurimit do të përdoren për sigurim të objekteve të Komunës së Prishtinës dhe nuk ka devijim apo keq zbatim të parasë publike, andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve konform kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit lidhur me analizën financiare dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Punës. Andaj, obligohet AK që gjatë ri-

vlerësimi të respektohen kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me analizën financiare dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Punës, si dhe të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK Prishtinë";
- 1x1 OE "SECURITY CODE" SHPK;
- 1x1 OE "DELTA SECURITY" SHPK;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.